



Komisioni për Implementimin e Rindërtimit  
për lokacionet religjioze Ortodokse në Kosovë

## **KOMUNIKATË PËR SHTYP – 19 maj 2006**

### **KOMISIONI PËR IMPLEMENTIMIN E RINDËRTIMIT AZHURNIM I PROGRAMIT - 2006**

Si rezultat i nënshkrimit të Termave të azhuruara të Referimit nga ana e Këshillit të Evropës, Kishës Ortodokse Serbe, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve-IPVQ, UNMIK-ut, Komisionit për Implementimin e Rindërtimit (KIR), të udhëhequr nga përfaqësuesja e Këshillit të Evropës Emma Carmichael, janë pajtuar këtë javë për t'u pajtuar rreth programit të projektit për vitin 2006.

Raundi i parë i tenderëve për punët e plota të rindërtimit do të lansohet në fillim të qershorit për Shën Joanikije në Deviç dhe Peshkopalen e Shën Gjergjit, Prizren. Lansimi i dytë i tenderëve do të pasojë në fillim të korrikut për Shën Nikollën, Prishtinë, Shën Gjergjin (Runoviç) në Prizren, Shën Ilinë në Vushtrri dhe Paraqitjen e Virgjëreshës në Bellopojë.

Lansimet e tenderëve reflektojnë prioritetet e Kishës Ortodokse Serbe për rindërtim. Tenderët do të shpallen në gazeta dhe në faqen e internetit të KIR e cila për momentin është duke u ndërtuar.

Pritet që punët do të fillojnë në lokacione në fillim të gushtit dhe do të përfaqësojnë një zhvillim të konsiderueshëm në rindërtimin e Kishave Ortodokse Serbe të dëmtuara gjatë marsit 2004. Punët në këtë fazë të parë të rindërtimit të plotë do të kompletohen deri në dhjetor 2006 dhe do të vazhdojnë me fazën përfundimtare të rindërtimit të brendshëm në vitin 2007.

Lansimi i tenderit për riparimet e kulmit të Kishës së Ljeviskës në Prizren do të rishpallet në fillim të qershorit dhe do të përcjell procedurat e rishikuara të prokurimit të cilat janë caktuar këtë vit. Punët riparuese janë riprogramuar që të fillojnë në fillim të korrikut dhe do të kompletohen në fund të gushtit 2006.

Komisioni do të takohet në fillim të qershorit 2006 në përgatitjet për lansimin e runderit të parë të tenderëve.



Zyra e Sekretariatit të KIE në Kosovë, Ndërtesa UNHCR HQ, kati i 6, Kragujevci 8, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Dhoma 132, Nëna Terezë Nr. 35, Prishtinë, 10000, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62



Komisioni për Implementimin e Rindërtimit  
për lokacionet religjioze Ortodokse në Kosovë

Puna e vazhdueshme e Komisionit për Implementimin e Rindërtimit është e përkrahur nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, IPVQ-të dhe UNMIK-u dhe i është dhënë përkrahje shtesë nga Agjencia Evropiane për Rindërtim.



Zyra e Sekretariatit të KIE në Kosovë, Ndërtesa UNHCR HQ, kati i 6, Kragujevci 8, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Dhoma 132, Nëna Terezë Nr. 35, Prishtinë, 10000, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62